

GJUHËSIA E TEKSTIT-DETYRIM PËR STUDIMIN E GJUHËS

Zeqirja IBRAHIMI¹

¹Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup

Kur një student i filologjisë i dëgjon në tavolinën afër tij dy njerëz që porosisin kafe, duke thënë: “Më jep një kafe pa sheqer, ju lutem.” (i pari) dhe “Po ashtu.” (i dyti), si do ta analizojë ai këtë dialog nëse i qaset me njohuritë e tij të fonetikës/fonologjisë, leksikologjisë dhe gramatikës, që i ka mësuar në studimet e tij të gjuhësisë? Informacionet e tij mbi fonemat, morfemat, leksemat, togfjalëshin, fjalinë e periudhën nuk ia japin shpjegimin se si funksionon gjuha në këtë dialog. Shpjegime me terma si theksi, intonacioni, emri, mbiemri, përemri, kategoritë gramatikore, fjalia urdhërore, fjalia mungesore etj., të gjitha janë të pamjaftueshme për ta shpjeguar se si fjalia e dytë merr kuptim vetëm pranë fjalisë së parë. Secili që e dëgjon këtë fjali e di se përmbajtja e plotë e saj është “Edhe mua një kafe pa sheqer, ju lutem”. Kjo dukuri në gjuhësinë e tekstit njihet si substituum ose zëvendësim.

Nëse ne themi “Ai fle shumë.”, ne nuk e dimë se kush është ai që fle shumë. Por, nëse pas kësaj fjalie e kemi fjalinë “Gazmendit ia kishte ëndja gjumin”, ne kështu e kemi kuptuar edhe fjalinë e parë. Kjo dukuri në gjuhësinë e tekstit njihet si referim kataforik.

* * *

Duke i parë shembujt e mësipërm, ku elementet gjuhësore në tekst dekodohen përmes elementeve të tjera gjuhësore, e kuptojmë detyrimin që gjuha të kuptohet e të studiohet në vetë aktin e komunikimit ose në tekstin si tërësi. Kjo kërkon një qasje tjetër të studimit të gjuhës. Ajo është qasja semantike ose kuptimore në studimin e gjuhës, ndërsa disiplina e gjuhësisë që merret me studimin e këtillë të gjuhës është *gjuhësia e tekstit*. Pra, me një fjalë, gjuhësia e tekstit është një studim semantik i gjuhës.

Meqë shumica e teksteve nuk e japin mesazhin e tyre në mënyrë eksplicite, njëri ndër problemet kryesore për kuptimin e tekstit është kuptimi i koherencës së tij. Me *koherencë* nuk nënkuptohet vetëm një fenomen gjuhësor i tekstit, por me të duhet të përfshihen të gjithë mekanizmat gramatikorë, pra tiparet sintaksore-semantike, madje edhe tematike-pragmatike.

Edhe për nocionet *kohezion* dhe *koherencë* jepen mendime të ndryshme. Kështu gjuhëtarët Michael A.K. Halliday Halliday dhe Ruqaiya Hasan, në studimin monumental të kësaj disipline shkencore “Cohesion in English”, nuk bëjnë edhe ndonjë dallim më të shtruar ndërmjet *kohezionit* dhe *koherencës*. Ata për të dyja rastet e propozojnë termin *kohezion*.

Një përkufizim më i thukët për këto dy nocione nxirret nga modeli i gjuhës i propozuar nga Noam Chomsky, i cili bën ndarjen e gjuhës në: struktura paralele dhe në struktura të thella. Duke iu referuar kësaj ndarjeje, kuptohet se *kohezioni* ndodh në rrafshin e strukturës sipërfaqësore të tekstit, ndërsa *koherenca* në rrafshin e strukturës së thellë të tekstit (Çeliku, 2005: f. 63).

Kjo nënkupton se *kohezioni* krijon marrëdhëniet gjuhësore në tekst, pra në aspektin fonologjik, morfologjik, sintaksor dhe frazeologjik, ndërsa *koherenca* e ruan vazhdimësinë logjiko-semantike të teksteve. Kjo çështje është trajtuar edhe nga gjuhëtarët shqiptarë. Autorët Kladeta Dibra dhe Nonda Varfi, që mbështeten në studimet e Beaugrande & Dressler, me *kohezion* nënkuptojmë funksionet që njësitë e gjuhës i shpalosin për të vënë lidhje midis elementëve të tekstit sipërfaqësor. Kështu, falë *kohezionit*, çdo element i tekstit sipërfaqësor nuk mund të ekzistojë si njësi e pavarur, por fiton një vlerë të caktuar pikërisht sepse ndërkallet në tekst bashkë me elemente të tjera të gjuhës (Dibra & Varfi, 1999: f. 42). *Kohezioni*, sipas tyre, shpreh qëndrueshmërinë ose vazhdimësinë kuptimore të tekstit, ndërsa *koherenca* e përmbush atë që e lë të zbrazët *kohezioni*, i mbush zbrazëtitë e kohezionit. (Dibra & Varfi, 1999: f. 40).

Për prof. Xhevat Lloshin, *kohezion* ose përshtatje me kontekstin fjalësor kemi kur ndeshim përshtatje me atë që është thënë, që në fakt është një përshtatje josipërfaqësore, por përshtatje që realizohet në thellësi të tekstit (Lloshi, 2001: f. 299).

Marrë në përgjithësi, mund të themi se *një tekst është koheziv meqë ka strukturë sipërfaqësore të realizuar me lidhjet ndërmjet fjalive dhe është koherent meqë pranuesi i tekstit e pranon tekstin duke e njohur edhe mjedisin e jashtëm*. Teksti është koherent në raport me kontekstin e situatës, përmes saj besnik edhe ndaj stilit, dhe në raport me vetveten, pra koheziv.

Nga sa mund të vërehet, kohezioni shprehet pjesërisht përmes gramatikës dhe pjesërisht përmes fjalorit, që ndryshe mund ta definojmë si kohezion gramatikor dhe kohezion leksikor. Për shembull, në kohezionin që krijohet duke e përdorur një nyje kemi kohezion gramatikor, ndërsa me përsëritjen e një lekseme krijohet kohezion leksikor. Në gjuhësinë e tekstit referimi, zëvendësimi dhe elipsa paraqesin kohezion gramatikor. Edhe me lidhëzorët kemi kryesisht kohezion gramatikor, pos kur kemi lidhëzor që e marrim si leksemë. Megjithatë kohezioni, si marrëdhënie, gjithnjë mbetet kuptimor.

Sipas autorëve të sipërpërmendur Halliday & Hasan, për kohezionin e tekstit shërbejnë disa mënyra të ndërtimit të marrëdhënieve kuptimore, si:

- substitiuimi (zëvendësimi) dhe elipsa (lënia jashtë, rënia):
- lidhja leksikore (rimarrja);
- referimi (orientimi, kahëzimi në tekst);
- konjunksioni (lidhja me mjete gjuhësore).

Zëvendësimi nënkupton se zëvendësohen pjesët që zakonisht janë “informative”, përkatësisht pjesët tashmë të njohura nga konteksti dhe nga situata.

P.sh.:

(1) - *Unë do të marr një kafe turke.*

- *Edhe unë njësoj.*

Ndërkaq *elipsa* më së miri vihet re në përgjigjet, komentet ose replikat.

P.sh.:

(1) *A erdhi Agimi? – Po.*

(2) *A shkojmë në Tiranë? – Jo. – Pse? – Kot.*

Përsëritja e drejtpërdrejtë e elementeve quhet *rimarrje*. *Rimarrja* zakonisht është më e shpeshtë në ligjërimin gojor, kjo për arsye se ata që flasin, nga prirja që të mos i përsërisin gjërat që i kanë thënë, duke respektuar durimin e dëgjuesit, duke pasur parasysh kohën e shkurtër që kanë në dispozicion ose duke krijuar ligjërim sa më konciz, u referohen elementeve që i kanë thënë më parë:

P.sh.: *Gjellës mund t'i mungojnë shumë gjëra, mund t'i mungojë kripa, mund t'i mungojë ngjyra, por mirë është që të mos i mungojë shija.*

Rimarrja shpesh përdoret edhe për qëllime retorike, veçmas nëpër fjalime publike, kur një element gjuhësor përsëritet për të krijuar efekt tek dëgjuesit.

P.sh.: **Rilindja** e bëri Shqipërinë të rilindur. **Rilindja** ishte rilindje për shqiptarin. **Rilindja** është identiteti ynë kombëtar. **Rilindja** është rruga e vetme për të rilindur Shqipëria. **Rilindja** është mundësia e vetme e integritimit dhe përparimit.

Referimi është kategori e kohezionit që ndërtohet duke i lidhur elementet gjuhësore përmes referimit mes njëra-tjetrës. Referimi mund të jetë jashtëgjuhësor (ekzoforik), kur një folës u referohet gjërave të (p.sh. *E shihni këtë përmendore të Skënderbeut?* – duke bërë shenjë kah përmendorja në sheshin e Tiranës), dhe brendagjuhësor (endoforik), kur referimi është brenda në tekst ose në vetë aktin e komunikimit. Një folës ose një autor, që ta lidhë atë që e ka thënë ose që do ta thotë, u referohet elementeve gjuhësore tashmë të njohura ose atyre që do të vijnë. Nëse u referohet elementeve gjuhësore tashmë të njohura, kjo quhet *anaforë*, ndërsa nëse u referohet elementeve që do të vijnë, kjo quhet *kataforë*.

P.sh.

*Ndërsa bëhej gati fillimi i pjesës së dytë, **futbollisti** bëhej gati me ngut. Ai ishte i entuziazmuar, por nuk e jepte veten as në këtë rast.* (anaforë)

Ju që e vutë në dyshim shpjegimin tim. (kataforë)

Ajo që gjykojmë se është më e rëndësishme në këtë artikull, për ta shpjeguar arsyen se pse është kaq me rëndësi njohja e gjuhësisë së tekstit, është lidhja e tekstit, që në gjuhësinë e tekstit njihet me nocionin *konjunksion* ose *bashkëlidhje*. Kjo lidhje nuk është si lidhja sintaksore, që lidh dy ose më shumë gjymtyrë në fjali, por kjo është një mënyrë lidhjeje që i lidh paragrafët mes vete dhe, madje, gjithë tekstin sado që të jetë i gjatë ai. Dhe, pikërisht këto mjete të lidhjes, që njihen si *konektorë* ose *bashkëlidhëzorë*, janë sinapsat që i lidhin fjalitë dhe paragrafët mes vete, për ta endur rrjetën e tërë, që është teksti.

Në të vërtetë, gjuhësia e tekstit si lidhje kuptimore i konsideron edhe lidhjet sintaksore me bashkërenditje e nënrenditje, por kur i vështron në qasjen semantike, ajo i ndan mjetet e lidhjes së tekstit (konektorët) në:

- konektorë relativë: përemrat lidhorë: *që, i cili, e cila, çka*; ndajfoljet: *ku, ashtu, si, ashtu si, prej ku, sikur* etj.
- konektorë lidhëzorë: *e, dhe, por, ndërsa, e as, veç sepse, ndërkaq përveç kësaj, por pa marrë parasysh atë* etj.
- konektorë rrethorë: *megjithatë, në fakt, përkundrazi, sipas kësaj, para së gjithash, për shkak të kësaj, dhe përkundrazi, e njëherazi, megjithatë, megjithëkëtë* etj.
- konektorë frazeologjikë: *së pari, së dyti, së treti, në radhë të parë, nga njëra anë, nga ana tjetër, për shembull, në një mënyrë, me fjalë të tjera, pa marrë parasysh* etj.
- konektorë prepozicionalë: *çdoherë është me rëndësi të dihet se, sa i takon kësaj, në radhë të parë duhet të thuhet se, gjithsesi duhet të mbahet llogari për* etj.

Kur bëhet fjalë për ndërtimin e stileve të veçanta të gjuhës, tre llojet e para të konektorëve nuk krijojnë ndonjë distinkcion, por kur bëhet fjalë për stilin e veprimtarisë teknike-shkencore, vijnë në shprehje më dendur konektorët prepozicionalë, që vërehen më pak se në stilet e tjera të gjuhës, ku mund të shihen si mjete rënduese të tekstit. Në anën tjetër, konektorët frazeologjikë gjejnë përdorim më të madh veçmas në stilin e veprimtarisë shoqërore-politike (në publicistikë, ligjërimin politik etj.), por në trajta të ligjërimit shpjegues hasen dendur edhe në stilin e veprimtarisë teknike-shkencore. Në disertacionin tonë të doktoratës (akoma i pabotuar) këto i kemi llogaritur edhe me përqindje, por për shkak të natyrës së këtij punimi, vendosëm që mos ta ngarkojmë tekstin më shumë.

Derisa i analizojmë konektorët ose mjetet e lidhjes, në studimet e gjuhësisë së tekstit është vënë re se ato janë elemente gjuhësore me të cilat ndërtohet edhe tipi i ligjërimit. Falë tyre, ne jemi në gjendje që ta përkufizojmë qëndrimin e autorit të tekstit se a është *kundërshtues*, *shpjegues*, *përfundues* e kështu me radhë. Në bazë të kësaj analize, konektorët janë ndarë në:

- adversativë (kundërshtorë), që prodhojnë ligjërimit kundërshtor;
- eksplikativë (shpjegues), që prodhojnë ligjërimit shpjegues;
- konkluzivë (përfundues), që prodhojnë ligjërimit përfundues; dhe
- kauzativë (shkakorë), që prodhojnë ligjërimit kauzal ose shkakor.

Ja si duken këta konektorë dhe ligjërimit përkatës në një shembull:

*Ministri i Arsimit ka vendosur t'i rrisë rrogat për 20%. **Megjithatë**, ministri harron se kjo rritje nuk e mbulon inflacionin. (ligjërimit kundërshtor)*

*Ministri i Arsimit ka vendosur t'i rrisë rrogat për 20%. **Në të vërtetë**, ministri këtë e ka bërë disa herë. (ligjërimit shpjegues)*

*Ministri i Arsimit ka vendosur t'i rrisë rrogat për 20%. **Kjo vjen për arsye se ky ka qenë premtimi i tij në bisedimet me sindikatën.** (ligjërimit shkakor)*

*Ministri i Arsimit ka vendosur t'i rrisë rrogat për 20%. **Përfundimisht**, ministri e ka marrë vendimin e duhur. (ligjërimit përfundues)*

Duke i parë konektorët në ligjëratë komunikimi, një studiues i gjuhës është në gjendje që ta tipizojë edhe natyrën e tekstit. Fjala bie, në tekste shkencore rëndom kemi ligjërimit shpjegues dhe përfundues, pos në tekstet shkencore-polemizuese, ku mund të kemi edhe ligjërimit kundërshtor. Ndërkaq, ligjërimit kundërshtor kemi dendur në stilin e veprimtarisë shoqërore-politike, në gazetari, në diskursin politik, por edhe në ligjërimit e figurave publike etj.

Në të vërtetë, autorët e mirë dinë ta ndërtojnë mirë tekstin e tyre, duke mos i ngatërruar këto elemente gjuhësore. Kështu, në një tekst universitar nuk është tipike që autori të përdor konektorin *shkurt e shqip*, por në një tekst gazetaresk ky është konektor tipik. Siç nuk është tipike që konektori *nga kjo që e thamë*, mund të konkludojmë se të përdoret në një roman.

Studimi i gjuhësisë së tekstit, më konkretisht i kategorisë së konjunksionit, i konektorëve dhe tipave të ligjërimit, na ka sjellë në një informacion po ashtu shumë të rëndësishëm, që del përtej gjuhësisë. Gjatë analizës së konektorëve në tipa të veçantë të ligjërimit, duke përdorë tekste të autorëve të ndryshëm, kemi vërejtur se secili autor e ka korpusin e tij tipikë të konektorëve, ndonëse ai mund të mos e dijë se ka krijuar një korpus identiteti në ndërtimin e tekstit. Madje, në disertacionin tonë këtë e kemi llogaritur me përqindje, duke e parë saktë se cilët janë konektorët tipikë të autorit përkatës.

Në të vërtetë, analizë e këtillë bëhet në një disiplinë tjetër, që është e kombinuar mes gjuhësisë dhe kriminalistikës, e që njihet si forenzika gjuhësore. Detyra e saj është që në ekspertizat gjyqësore ta zbulojë autorin e një teksti anonim ose të nënshkruar me pseudonim. Kështu, duke i analizuar mjetet gjuhësore (gabimet e përsëritura, gabimet në shkrimin e fjalës, mënyrat e ndërtimit e fjalive, shprehjet frazeologjike etj.) dhe duke i krahasuar ato me tekste të tjera, ata e zbulojë autorin e një teksti. Dhe, ky zbulim shpesh është më saktësi absolute.

Rëndësia e studimit të gjuhësisë së tekstit

Pasi që kemi bërë një paraqitje të shkurtër e të sintetizuar të gjuhësisë së tekstit, në pjesën vijuese dëshirojmë të vëmë në pah se ku është rëndësia praktike e studimit të këtillë të gjuhës.

1. **Analiza semantike.** Duke e studiuar tekstin me qasje semantike, ne e kuptojmë se elementet gjuhësore nuk janë të pavarura dhe të hedhura në tekst, porse ato përbëjnë një endje të qëllimshme dhe të planifikuar të autorit. Lidhja kuptimore e tekstit e nxjerr në plan të dytë analizën gramatikore të gjuhës, sepse fjala, togfjalëshi, fjalia e periudha dalin në plan të dytë

të analizës, ngase ato nuk kanë asnjë kuptim në vetvete nëse nuk vihen në marrëdhënie kuptimore me njësitë e tjera gjuhësore.

2. **Ndërtimi i tekstit.** Analiza e këtyllë gjuhësore na krijon një dioptri të re të njohjes së tekstit, sepse edhe një fjalë të vetme (siç janë reklamat ose sloganet) ose një vepër të tërë me qindra faqe ne arrijmë ta kundrojmë në kuptimin e thellë që mbart në vete, në referimin që e krijon me elemente jashtëgjuhësore dhe brendagjuhësore etj.
3. **Kohezioni.** Njohja dhe dallimi i kohezionit na mundëson që ta dallojmë një tekst sa është koheziv dhe sa nuk është. Madje, një njohës i mirë i kohezionit është në gjendje t'i dallojë edhe "gabimet" e autorit në ndërtimin e kohezionit të tekstit. Në këtë mënyrë, një redaktor i mirë gjuhësor, me këso përgatitje, përveçse do ta redaktonte tekstin në rrafshin drejtshkrimor e gramatikor, do të futej edhe në zbulimin e këtyre "lëshimeve" të kohezionit, për t'i korrigjuar ato dhe për ta ngjeshur tekstin e për ta bërë më koheziv. Ai do të duhej ta dinte se kur ka funksion të kohezionit rrimarja e kur përsëritja e një njësie gjuhësore bëhet patetike dhe e rëndon tekstin, andaj duhet zëvendësuar. Duke e redaktuar një tekst të gjatë, redaktori është në gjendje t'i gjejë edhe "prerjet" ose "pauzat", ku autori e ka humbur vijën e kohezionit dhe është në gjendje "t'i riparojë" ato.
4. **Redaktimi i ligjërit.** Një redaktor i mirë, me përgatitje të mirë në gjuhësinë e tekstit, por edhe me formim të mirë filologjik, është në gjendje që ta redaktojë edhe ligjërimin e një teksti. Duke ia vendosur konektorët kundërshtorë një teksti që synon kundërshtimin, ai arrin ta rrisë fuqinë ligjëruese kundërshtore të tekstit ose atë shpjeguese nëse bëhet fjalë për ligjërim shpjegues. Nëse e njeh mirë ligjërimin, ai e di mirë se cili konektor me cilin konektor duhet zëvendësuar që të arrihet ky efekt ligjërimor në tekst.
5. **Përdorimi i drejtë i konektorëve.** Redaktorit të mirë gjuhësor edhe po t'ia japësh një tekst pa konektorë, ai është në gjendje t'i vendosë konektorët e duhur në vendin e duhur dhe ta ndërtojë edhe kohezionin e tekstit, ta ruajë gjuhën specifike të stilit të veçantë gjuhësor, por edhe ta ruajë tipin e ligjërit. Këtu më poshtë po e japim një shembull se si do të duhej një tekst pa konektorë dhe si duket pasi t'i vihen konektorët. Eksperimenti është bërë me një fragment të librit të prof. Shaban Demirajt "Gjuhësia ballkanike".

Teksti pa konektorë:

- 1) Disa gjuhëtarë kanë trajtuar si dukuri ballkanike shfaqjen e rotacizmit *-n- > -r-* në gjuhën shqipe dhe në rumanishte.
- 2) Ndalemi pak në këtë çështje, duke parashtruar shkurt kohën e shfaqjes së kësaj dukurie në këto dy gjuhë.
- 3) Rotacizimi i *-n-së* ndërzanore në gjuhën shqipe është përfutur vetëm në dialektin jugor të saj.
- 4) Ai ka prekur fjalët e vjetra anase, huazimet nga greqishtja e vjetër dhe huazimet nga latinishtja.
- 5) Ai nuk i ka prekur huazimet nga greqishtja e mesme, as nga sllavishtja.
- 6) Shumica e gjuhëtarëve kanë arritur në përfundimin që ky ndërrim fonetik ka pushuar së vepruari para depërtimit të sllavizmave në gjuhën shqipe, para shekujve VII-VIII të e.r.
- 7) Jokli dhe Çabej kanë shprehur mendimin se rotacizmi në dialektin jugor të shqipes ka vazhduar deri nga fundi i shekullit X të e.r. e më vonë.
- 8) Ata kanë përmendur disa raste të kufizuara në mbështetje të mendimit të tyre.
- 9) Rastet sporadike, (që) përmendin Jokli dhe Çabej, nuk e përmbysin mendimin e mëparshëm që rotacizmi në toskërishte duhet të ketë pushuar së vepruari para depërtimit të sllavizmave në gjuhën shqipe.

- 10) Ato vetëm dëshmojnë se disa raste të pakta dhe të veçuara rotacizmi janë shfaqur me rrugë analogjike në dialektin jugor, (pasi) kjo dukuri kishte pushuar së vepruari si proces fonetik.
- 11) Rotacizmi në toskërishte me rrugë fonetike duhet të jetë shfaqur pas evolucionit të *-a-së* në *-ë-* para bashkëtingëlloreve hundore.
- 12) Do të kishin munguar kushtet fonetike për një evolucion të tillë.
- 13) (Duke marrë parasysh) edhe pozicionin gjeografik të trevave, (ku) është shfaqur rotacizmi *-n- > -r-* në shqipe dhe në rumanishte, nuk del i mbështetur mendimi i atyre gjuhëtarëve, (që) shihnin një lidhje “midis këtyre dy gjuhëve ballkanike në këtë pikë.

Ja si do të dukej tani ky tekst me konektorët brenda kur të vendoset në një faqe libri:

Disa gjuhëtarë kanë trajtuar si dukuri ballkanike **edhe** shfaqjen e rotacizmit *-n- > -r-* në gjuhën shqipe dhe në rumanishte. **Prandaj po** ndalemi pak **edhe** në këtë çështje, duke parashtruar shkurt edhe kohën e shfaqjes së kësaj dukurie në këto dy gjuhë.

Siç dihet, rotacizimi i *-n-së* ndërzanore në gjuhën shqipe është përfutur vetëm në dialektin jugor të saj. Ai ka prekur **kryesisht** fjalët e vjetra anase **si edhe** huazimet nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja. **Në përgjithësi**, ai nuk i ka prekur huazimet nga greqishtja e mesme, as nga sllavishtja. **Për këtë arsye** shumica e gjuhëtarëve kanë arritur në përfundimin që ky ndërrim fonetik ka pushuar së vepruari para depërtimit të sllavizmave në gjuhën shqipe, **d.m.th.** para shekujve VII-VIII të e.r. **Por** disa gjuhëtarë të tjerë, **si p.sh.** Jokli dhe Çabej, kanë shprehur mendimin se rotacizmi në dialektin jugor të shqipes ka vazhduar deri nga fundi i shekullit X të e.r. e **ndofta edhe** më vonë. **Dhe për këtë** ata kanë përmendur disa raste të kufizuara në mbështetje të mendimit të tyre. **Por** rastet sporadike, **që** përmendin Jokli dhe Çabej, **në të vërtetë** nuk e përmbysin mendimin e mëparshëm që rotacizmi në toskërishte duhet të ketë pushuar së vepruari para depërtimit të sllavizmave në gjuhën shqipe. Ato vetëm dëshmojnë se disa raste të pakta dhe të veçuara rotacizmi janë shfaqur me rrugë analogjike në dialektin jugor, **edhe** pasi kjo dukuri **në përgjithësi** kishte pushuar së vepruari si proces fonetik.

Sidoqoftë, duhet pasur parasysh se rotacizmi në toskërishte me rrugë fonetike duhet të jetë shfaqur pas evolucionit të *-a-së* në *-ë-* para bashkëtingëlloreve hundore. **Përndryshe**, do të kishin munguar kushtet fonetike për një evolucion të tillë.

Në këto rrethana, **duke marrë parasysh edhe** pozicionin gjeografik të trevave, **ku** është shfaqur rotacizmi *-n- > -r-* në shqipe dhe në rumanishte, nuk del i mbështetur mendimi i atyre gjuhëtarëve, **që** shihnin një lidhje “midis këtyre dy gjuhëve ballkanike në këtë pikë

6. **Vlerësimi i tekstit.** Njohja e këtillë e gjuhës, duke hyrë në thellësinë e lidhjeve kuptimore të tekstit, na mundëson edhe ta dallojmë tekstin e mirë nga teksti i dobët në kuptim të ndërtimit të kohezionit, të përdorimit të drejtë të konektorëve, në kuptim të ndërtimit të drejtë të ligjërit, si dhe në kuptim të ndërtimit të drejtë të tekstit tipik për stilin gjuhësor, të cilin e synon autori. Kjo kalon përtej vlerësimit gjuhësor, ngase këto studime të tekstit i përfshin, veçmas në tekstet letrare, edhe kritika letrare.
7. **Nga gjuhësia e tekstit te forenzika e gjuhës.** Një studiuesi të mirë të gjuhësisë së tekstit i mundësohet një përgatitje e mirë profesionale që dijet e nxëna në këtë fushë t’i aplikojë në zbulimin e teksteve anonime ose të botuara me pseudonime, që mund të bëhet për arsye filologjike (studimi i teksteve të hershme) ose në fushën e kriminalistikës, ku kjo bëhet për qëllime të ekspertizave gjyqësore.

Përfundim

Marrë në përgjithësi, nga gjithë kjo që u tha më sipër, mund të konkludojmë se studimi i gjuhësisë së tekstit nuk është vetëm pasurim i njohurive gjuhësore të një gjuhëtari, por është detyrim që një gjuhëtar ta njohë, ta kuptojë, ta zërthejë dhe ta studiojë gjuhën si tekst ose si akt i komunikimit.

Duke bërë shpjegime se në çfarë pika të studimit arrin gjuhësia e tekstit, kemi argumentuar se sa e thellë dhe e rëndësishme është njohja e kësaj disipline nga gjuhëtarët. Përveç kësaj, gjuhësia e tekstit është mënyrë e mirë që u hyn në punë veçmas redaktorëve, kur tash – pas zhvillimit teknologjik – shumë çështje drejtshkrimore i zgjidh kompjuteri, andaj redaktorit i mbetet të futet në thellësi të tekstit, për ta redaktuar kohezionin dhe ligjërimin.

Konkluzioni ynë është se gjuhësia e tekstit, si disiplinë relativisht e re e gjuhësisë, mundëson që gjuha të analizohet edhe nga kënde të tjera, që e lidhin edhe me disiplina të tjera gjuhësore dhe jogjuhësore.

Prandaj, po e përfundojmë këtë artikull me mendimin se katedrat e gjuhës e kanë detyrim që ta përfshijnë këtë lëndë në studimin e tyre dhe t'i nxisin studiuesit e rinj për studime më të thelluara në këtë fushë të gjuhësisë.

Burimet:

- [1]. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 1995, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë.
- [2]. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 1997, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë.
- [3]. Çeliku, Arbër., 2005, *Koherenca tekstore*, Asdreni, Shkup.
- [4]. Demiraj, Shaban., 1994, *Gjuhësia ballkanike*, Logos-A, Shkup.
- [5]. Dibra, Klodeta & Varfi, Nonda., 1999. *Gjuhësi teksti*, SHBLU, Tiranë.
- [6]. Glovacki-Bernardi, Zbrinjka., 2004, *O Tekstu*, Školska knjiga, Zagreb.
- [7]. Halliday, M.A.K. & Hasan, Ruqaiya., 1984, *Cohesion in English*, Longman, London and New York,.
- [8]. Lloshi, Xhevat., 2001, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, SHBLU, Tiranë.
- [9]. Velčić, Mirna., 1987, *Uvod u lingvistiku teksta*, Školska knjiga, Zagreb.